



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 57/17 prot.

Tiranë, më 06. 08. 2026

V E N D I M

Nr. 214, datë 06. 08. 2026

Mbështetur në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me nr. 10, datë 07.01.2026², të paraqitur nga A. P., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë dhe Komisariatit të Policisë Përmet³, në të cilën pretendohet diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Ankuesi, A. P., në muajin shtator 2025, pas plotësimit të të gjitha kriterëve të pranimit, përfshirë dokumentacionin, testet fizike dhe psikologjike, është njoftuar nga strukturat e Akademisë së Sigurisë se ishte pranuar për të ndjekur studimet në ciklin e parë Bachelor. Në vijim, pasi ka kryer të gjitha procedurat e regjistrimit, ka firmosur kontratën përkatëse për ndjekjen e studimeve pranë Akademisë së Sigurisë.

Më datë 25 nëntor 2025, A. P. është njoftuar se me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është përjashtuar nga Akademia e Sigurisë, me efekt të menjëhershëm me pretendimin “Mosplotësim i kriterëve të besueshmërisë dhe integritetit”. Lidhur me këtë, ankuesi referon se nuk i janë dhënë sqarime të mëtijshme pavarësisht kërkesave të tij.

A. P. referon se nuk ka kryer asnjë vepër penale dhe nuk ka pasur precedent të mëparshëm penal, duke u pajisur edhe me dëshminë e penalitetit të pastër, lëshuar nga e-albania.

¹ Në vijim do t'i referohemi LMD.

² Plotësuar ankesa më datë 14.01.2026.

³ Shtuar si subjekt kundër të cilit është drejtuar ankesa përmes e-mail-it dërguar Komisionerit, më datë 10.02.2026.

⁴ Ankuesi ka përfshirë tek çdo shkak tjetër, faktin që ka qenë i shoqëruar 3 herë në polici për sqarime të konflikteve verbale.

⁵ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Gjatë 3 viteve të fundit ankuesi thekson se ka qenë tri herë i shoqëruar në polici për sqarime të konflikteve verbale, të lidhura me biznesin familjar që ushtron në qytetin e Përmetit, pa asnjë akuzë të ngritur dhe pa asnjë procedim penal.

Sa më sipër, ankuesi pretendon se është vënë në pozita diskriminuese duke u përjashtuar nga Akademia e Sigurisë për shkak të faktit që ka qenë i shoqëruar 3 herë në Komisionin e Policisë Përmet për sqarime të konflikteve verbale.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri :

- *Të hetojë procedurën e ndjekur nga Akademia e Sigurisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në vlerësimin e besueshmërisë.*
- *Të verifikojë nëse ka pasur diskriminim, trajtim të pabarabartë apo shkelje të së drejtës për transparencë dhe proces të rregullt administrativ.*
- *Të kërkojë sqarim të plotë dhe dokumentim nga institucionet përkatëse mbi bazën e të dhënave që kanë çuar në vlerësimin negativ.*
- *Të rekomandojë marrjen e masave korrigjuese, nëse vërtetohet diskriminim, përfshirë rikthimin në procesin e pranimi ose rivlerësimin e çështjes.*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të paraqitur nga ankuesja, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga

Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 57/1 prot., datë 19.01.2026, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Akademia e Sigurisë, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje për sa më lart, Akademia e Sigurisë, përmes shkresës⁶ nr. 162/2 prot., datë 26.01.2026, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: *“...Me urdhër Nr. 1387, datë 18.09.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për fillimin e studimeve të ciklit të parë “Bachelor, në Akademinë e Sigurisë, vitit akademik 2025- 2026” për fitimin e gradës “Nënkomisar”, A. P., ka filluar studimet në vitin e parë, cikli “Bachelor”, në programin “Siguria dhe Hetimit”, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë.*

Gjatë përgatitjes së dosjeve dhe rikontrollit të dokumentacionit të studentëve të vitit të parë të cilët kanë filluar studimet në datën 06.10.2025, u konstatua se në Vërtetimin e Besueshmërisë të A. R. P., hartuar në zbatim të nenit 85 dhe 86 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr. 112, datë 24.02.2025, i përpiluar nga Komisariati i Policisë Përmet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë, ishte i evidentuar “Nuk gëzon besueshmëri dhe është i papërshtatshëm”, për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Pas informacionit me nr. 2643, datë 20.11.2025, “Mbi studentin e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit A. R. P.”, dërguar nga ana jonë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, këtij studenti me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 2900/1, datë 21.11.2025, “Për ndërprerjen dhe largimin nga programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor, në Akademinë e Sigurisë të një studenti”, ju ndërprejnë studimet me motivacion: “Mosplotësim i kriterëve ligjorë të besueshmërisë dhe integritetit”.

A. P., pas daljes së urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, menjëherë është bërë me dije për arsyen dhe motivacionin e ndërprerjes së studimeve...

Për arsye se dokumenti “Vërtetimi i Besueshmërisë” është i klasifikuar “I kufizuar” nuk mund t’jua vëmë në dispozicion...”.

2. Ndërkohë përmes e-mail-it datë 10.02.2026, ankuesi kërkoi që ankesa e tij dhe subjektet kundër të cilëve të vijoje shqyrtimi i saj të jenë: Akademia e Sigurisë dhe Komisariati i Policisë Përmet.

Në këtë kuadër, Komisioneri përmes shkresës nr. 57/3 prot., datë 17.02.2026, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë dhe Komisariati i Policisë Përmet, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 57/2 prot., datë 27.01.2026.

Me shkresën⁷ nr. 988/1 prot., datë 19.02.2026, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin sa i përket ankesës së paraqitur nga ana e A. P., duke sqaruar ndër të tjera se: “...Në zbatim të Ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, Kreu VII “Pranimi dhe Ecuria në Karrierë”, neni 73, 81 dhe 82, pikat 1, 2, 3 dhe 4, ku citohet “Studentët e pranuar në programet e formimit bazë ose në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë, të cilët nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, i nënshtrohen verifikimit të besueshmërisë”.

Verifikimi i besueshmërisë kryhet nga Strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, konkretisht strukturat e Hetimit të Krimit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër.

Me shkresë nr. 3525, datë 20.08.2025, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër vërtetimi i besueshmërisë të shtetasit A. R. P. është përcjellë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPP Shtetit Tiranë.

Pranimi, administrimi dhe verifikimi i dokumentacionit për aplikantët, studentët e pranuar për studimet “Bachelor”, në programin “Siguria dhe Hetimi”, është kryer nga strukturat përgjegjëse në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit në Akademinë e Sigurisë, Tiranë”.

3. Komisioneri përmes e-mail-it datë 20.02.2026, i përcolli ankuesit një kopje të shkresës së Akademisë së Sigurisë, si dhe kërkoi parashtrime me shkrim nga ana e tij. Në këtë kuadër, më datë 20.02.2026, përmes e-mail-it, ankuesi depozitoi parashtrimet e tij sa i përket përgjigjeve të vëna në dispozicion nga ana e Akademisë së Sigurisë.

Përmes shkresës⁸ nr. 1733/1 prot., datë 24.02.2026, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin sa i përket ankesës së paraqitur nga ana e A. P., duke sqaruar ndër të tjera se: “...Me Urdhrin nr. 1387, datë 18.09.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për fillimin e studimeve të ciklit të parë “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2025-2026, për fitimin e gradës “Nënkomisar”, shtetasi A. P. ka nisur studimet në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në programin “Siguria dhe Hetimi”.

Gjatë procesit të vlerësimit të dosjeve të studentëve të vitit të parë, të cilët filluan studimet më datë 06.10.2025, u konstatua se në dokumentin “Vërtetim Besueshmërie”, të lëshuar nga Komisariati i Policisë Përmet, për shtetasin A. P. rezultonte se “Nuk gëzon besueshmëri dhe është i papërshtatshëm” për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, neni 82, pika 1, parashikon se: “Studentët e pranuar në programet e formimit bazë ose në programet e studimit të ciklit të parë ‘Bachelor’ në Akademinë e Sigurisë, të cilët nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, i nënshtrohen verifikimit të besueshmërisë.”

Në rastin konkret, gjatë procesit të verifikimit të kandidateve, ndaj shtetasit A. P. janë evidentuar të dhëna që përbëjnë indikatorë të papërshtatshmërisë për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë dhe ushtrimin e funksioneve policore.

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 57/5 prot., datë 06.03.2026.

⁸ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 57/4 prot., datë 25.02.2026.

Këto të dhëna janë administruar nga Komisariati i Policisë Përmet, si struktura përgjegjëse për vlerësimin e besueshmërisë të kandidatit me banim në atë territor, në zbatim të procedurave të parashikuara në nenet 85 dhe 86 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 112, datë 24.02.2025. Ndër të dhënat e evidentuara përfshihen:

- *shoqërime të përsëritura administrative për konflikte dhe situata problematike me persona të ndryshëm në zonën e banimit, të cilat, edhe pse nuk përbëjnë vepër penale, përfaqësojnë të dhëna të rëndësishme për vlerësimin e riskut, stabilitetit emocional dhe përshtatshmërisë për punë policore;*
- *mospërputhje midis të dhënave të vetëdeklaruar nga kandidati dhe të dhënave të administruara nga strukturat territoriale;*
- *vlerësim negativ nga Komisariati i Policisë Përmet për integritetin dhe sjelljen në komunitet.*

Ky vlerësim përbën kriter ligjor të detyrueshëm, mbi të cilin nuk mund të vijojë procesi i trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

Ligji nr. 82/2024, neni 82, pika 2, parashikon se: “Procesi i verifikimit të besueshmërisë kryhet për të gjithë studentët e pranuar përpara fillimit të programit përkatës të studimit. Në rast se nga verifikimi i besueshmërisë rezulton se studenti ka lidhje të papërshtatshme me krimin e organizuar ose ka informacione që është i përfshirë në kryerjen e veprimtarive kriminale, vendoset përjashtimi i tij nga programi përkatës i formimit të Akademisë së Sigurisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, Akademia e Sigurisë, me propozimin nr. 2643, datë 20.11.2025, ka kërkuar përjashtimin e studentit nga programi i ciklit të parë “Bachelor”. Bazuar në këtë propozim, me Urdhrin nr. 2900/1, datë 21.11.2025, studentit A. P. i janë ndërprerë studimet për shkak të “mosplotësimit të kriterëve ligjorë të besueshmërisë dhe integritetit”.

Shtetasi A. P. është njohur menjëherë me vendimin dhe motivacionin për ndërprerjen e studimeve dhe i është vënë në dispozicion dokumentacioni përkatës.

Theksojmë se:

- *Gjatë procesit nuk është aplikuar asnjë kriter diskriminues i ndaluar nga nenet 1 dhe 3 të ligjit nr. 10221/2010;*
- *Procedura e ndjekur është e njëjtë për çdo aplikant që i nënshtrohet verifikimit të besueshmërisë;*
- *Vendimi për përjashtimin e kandidatit është marrë vetëm pasi vlerësimi i besueshmërisë ka rezultuar negativ, çka përbën kriter ligjor për ndërprerjen e procesit të pranimit.*

Sa i përket dokumentit “Vërtetim Besueshmërie”, ju bëjmë me dije se, për shkak të klasifikimit “I Kufizuar”, ai nuk mund të vihet në dispozicion. Një punonjës i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), i Drejtorisë së Hetimit Administrativ pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mund të paraqitet pranë Akademisë së Sigurisë për t’u njohur me përmbajtjen e këtij dokumenti.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbetet e gatshme të bashkëpunojë me institucionin tuaj për çdo verifikim të mëtejshëm ose sqarim shtesë që mund të nevojitet...”.

4. Në vijim, Komisioneri me e-mail-in datë 26.02.2026, i përcolli ankuesit parashtrimet e paraqitura nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Përmes e-mail-it datë 02.03.2026, ankuesi parashtroi ndër të tjera se përmes veprimeve dhe mosveprimeve, subjektet ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën kanë shkelur dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, legjislacionit për arsimin, Ligjit nr. 10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si rezultat i moskomunikimit të aktit të besueshmërisë, mungesës së arsyetimit dhe mosbashkëpunimit institucional.
5. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenin 40, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)”⁹, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 57/6 prot., datë 24.03.2026, vendosi të realizojë një seancë dëgjimore më datë 01.04.2026, ku ftoi palët në proces të merrnin pjesë për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.

Sipas njoftimeve të realizuara, seanca dëgjimore u zhvillua në datë 01.04.2026. Në të morën pjesë, pala ankuese, A. P., si dhe përfaqësues të subjekteve kundër të cilëve është depozituar ankesa: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përfaqësuar nga L. Sh.; J. Q., në cilësinë e Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër dhe E. P., në cilësinë e Shefit të Sektorit për Hetimin e Krimeve në Volum në Komisariatit e Policisë Përmet.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan parashtrësve me shkrim të depozituara paraprakisht pranë Komisionerit.

6. Me shkresën nr. 57/8 prot., datë 02.04.2026, Komisioneri iu drejtua sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, duke kërkuar ndër të tjera:
 - A është mbajtur ndonjë akt/procesverbal nga ana e komisionit përkatës për kontrollin apo rikontrollin e dosjeve të kandidatëve për student në Akademinë e Sigurisë? Nëse po të vihet në dispozicion të Komisionerit një kopje e tij.
 - Cilat ishin arsyet që çuan Akademinë e Sigurisë në rikontrollin e dokumentacionit të studentëve të vitit të parë?
 - Kur ka marrë dijeni Akademia e Sigurisë për Vërtetimin e Besueshmërisë për shtetasin A. P.? Kopje të shkresës përcjellëse.
 - A ka patur studentë të tjerë të larguar nga Akademia e Sigurisë pas rikontrollit të kryer? Të citohet numri i tyre dhe arsyet e largimit.
 - Përse ndërprerja e studimeve për A. P. është kryer pasi ai ka nisur vitin akademik, duke qenë se kontrolli i dokumentacionit të studentëve verifikohet përpara fillimit të studimeve?

⁹ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

- Kopje të Kontratës Individuale për ndjekjen e studimeve të nënshkruar nga A. P. dhe Akademia e Sigurisë.
- Kopje të aktit ligjor apo nënligjor në të cilin është parashikuar procedura që ndiqet për verifikimin e besueshmërisë.

Në përgjigje sa më lart, Akademia e Sigurisë përmes shkresës¹⁰ nr. 162/6 prot., datë 17.04.2026, sqaroi ndër të tjera se: “...Në zbatim të Urdhrit nr. 986, datë 08.07.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2025-2026”, Drejtoritë Vendore të Policisë, jo më vonë se data 22.08.2025 duhet të dërgonin Vërtetimet e Besueshmërisë së Aplikantëve, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për t’u përcjellë më pas pranë Komisionit të Pranimi, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

Gjatë fazës së verifikimit të integritetit dhe besueshmërisë për tu bërë pjesë e Policisë së Shtetit, Komisioni i Pranimi, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, ka pasur detyrimin të verifikojë Vërtetimet e Besueshmërisë të përgatitur nga Drejtoritë Vendore të Policisë nëpërmjet strukturave të hetimit të krimit, për 479 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) aplikantë që kanë marrë pjesë në procesin e konkurimit.

Me fillimin e procesit mësimor në datën 06.10.2025, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Komisioni i Pranimi përcjell dosjet e studentëve të vitit të parë tek Specialistja për administrimin e dokumenteve (AMZA), në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë dhe Shërbimeve Studentore, e cila në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga secili student përgatit të dhënat për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMLAL), dhe ia dërgon Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA-së), me qëllim marrjen e numrit të matrikullimit për çdo student.

Me përfundimin e këtij procesi dosjet e studentëve nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Shërbimeve Studentore, kalojnë në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Akademinë e Sigurisë.

Me marrjen në dorëzim të dosjeve nga Sektori i Burimeve Njerëzore, u rikontrollua i gjithë dokumentacioni i studentëve të vitit të parë me qëllim evidentimin e ndonjë mangësie. Gjatë këtij kontrolli u konstatua se në Vërtetimin e Besueshmërisë të A. R. P., shoqëruar me shkresën përcjellëse Nr. 3525 prot., datë 20.08.2025, “Dërgohen Vërtetimet e Besueshmërisë”, të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjrokastër, i përpiluar nga Komisariati i Policisë Përmet, ishte i evidentuar “Nuk gëzon besueshmëri dhe është i papërshtatshëm”, për t’u pranuar në strukturat e Policisë së Shtetit.

Në përfundim të kontrollit nuk u evidentuan mangësi të tjera në dosjet e studentëve, pra nuk ka pasur studentë të tjerë të larguar nga Akademia e Sigurisë. Pas konstatimit të këtij shënimi në Vërtetimin e Besueshmërisë së A. P., nga punonjësit e Sektorit të Burimeve Njerëzore u mbajt Proces-Verbali, me nr. 2052/8A, datë 20.11.2025.

Rikontrolli i dokumentacionit të kursanteve/studentëve, është një proces rutinë i Sektorit të Burimeve Njerëzore. Dosjet administrohen nga ky Sektor deri në përfundimin e studimeve, për t’u dërguar më pas pranë strukturave të policisë ku do të emërohen në detyrë.

¹⁰ Administruar pranë Komisionerit me nr. 57/9 prot., datë 21.06.2026.

Me Informacionin me nr. 2643, datë 20.11.2025, “Mbi studentin e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit A. R. P.”, dërguar nga ana jonë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, këtij studenti me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 2900/1, datë 21.11.2025, “Për ndërprerjen dhe largimin nga programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor, në Akademinë e Sigurisë të një studenti”, ju ndërprejnë studimet me motivacion: “Mos plotësim i kriterëve ligjore të besueshmërisë dhe integritetit”.

A. P., pas daljes së urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, menjëherë është bërë me dije për arsyen dhe motivacionin e ndërprerjes së studimeve... ”.

7. Me shkresën nr. 57/11 prot., datë 09.06.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, njoftoi Akademinë e Sigurisë, për kryerjen e inspektimit, me objekt njohjen me përmbajtjen e dokumentit “Vërtetim Besueshmërie”, për shtetasin A. R. P., të klasifikuar “I kufizuar”.

Mbështetur në kërkesat e Urdhrit nr. 70, datë 09.06.2026, inspektorët e KMD-së, u paraqitën pranë Akademisë së Sigurisë , ku morën takim me V. Ç, në cilësinë e Shefes së Sektorit të Burimeve Njerëzore në Akademinë e Sigurisë. Gjatë inspektimit, përfaqësuesja e Akademinë e Sigurisë, pas kontaktit me përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, informoi inspektorët e Komisionerit se mbështetur në Urdhër Nr. 923, datë 23.06.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dokumenti “Vërtetim Besueshmërie”, është informacion i klasifikuar dhe për këtë arsye mund të vihet në dispozicion vetëm me Urdhër të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në këto kushte, nga ana e V. Ç. u theksua se Akademia e Sigurisë nuk mund ta vendosë në dispozicion.

8. Me shkresën nr. 57/13 prot., datë 16.06.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke kërkuar bashkëpunimin e saj, për caktimin e një date për realizimin e një inspektimi pranë strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe njohjen me dokumentin “Vërtetim Besueshmërie”, të shtetasit A. R. P.
9. Bazuar në sa më sipër, në kushtet kur njohja me dokumentin “Vërtetim Besueshmërie”, të shtetasit A. R. P. dhe në kushtet kur nuk ka ndonjë ndalim ligjor që e pengon zgjatjen e afatit të procedurës, Komisioneri me vendimin nr. 57/14 prot., datë 16.06.2026, vendosi të zgjasë afatet procedurale për shqyrtimin e ankesës me nr. 10 regj, datë 07.01.2026, për 90 ditë të tjera.

Në përgjigje sa më lart, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përmes shkresës¹¹ nr. 2038/1 prot., datë 29.06.2026, sqaroi ndër të tjera se: “...Për realizimin e inspektimit nga ana juaj, për njohjen me dokumentin “Vërtetim Besueshmërie”, kërkojmë që personat të jenë të pajisur me CSP¹²...”.

¹¹ Administruar pranë Komisionerit me nr. 57/16 prot., datë 01.07.2026.

¹² Certifikatë Sigurie Personeli

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues

Sipas praktikës së konsoliduar të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimi i diskriminimit kërkon plotësimin kumulativ të disa elementëve: (i) ekzistencën e një trajtimi më pak të favorshëm ndaj subjektit ankues në krahasim me një person tjetër që ndodhet në një situatë të krahasueshme; (ii) lidhjen shkakësore midis këtij trajtimi dhe një shkak të mbrojtur nga neni 1 i LMD-së; dhe (iii) mungesën e një justifikimi objektiv e të arsyeshëm për trajtimin e diferencuar.

Nga analiza e fakteve dhe e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se verifikimi i besueshmërisë të cilit iu nënshtrua ankuesi është një procedurë e parashikuar shprehimisht nga neni 82 i ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, e zbatueshme në mënyrë të përgjithshme dhe të njëtrajtshme ndaj të gjithë kandidatëve/studentëve që pranohen në programet e ciklit të parë “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë, e që nuk janë më parë punonjës të Policisë së Shtetit. Sipas informacionit të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Akademia e Sigurisë, ky verifikim është kryer për të gjithë 479 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) aplikantët e vitit akademik 2025-2026, pa përjashtim, nëpërmjet të njëjtave struktura territoriale të Hetimit të Krimit.

Lidhur me procedurën e ndjekur konkretisht ndaj ankuesit, nga aktet e administruara gjatë hetimit rezulton se subjekti ankues iu nënshtrua të njëjtës procedurë verifikimi besueshmërie që ndiqet në mënyrë të përgjithshme dhe të njëtrajtshme për çdo kandidat/student të pranuar në ciklin e parë “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë, pa u evidentuar asnjë element që të tregojë trajtim të diferencuar, më të rëndë apo më pak të favorshëm ndaj tij në krahasim me kandidatët e tjerë në të njëjtën situatë. Në këto kushte, Komisioneri çmon se nuk ka pasur diferencim në trajtimin procedural të A. P.

Kriteri mbi të cilin është bazuar përjashtimi i ankuesit, vlerësimi i besueshmërisë dhe integritetit, i kryer nga struktura kompetente territoriale mbi bazën e të dhënave për shoqërime të përsëritura administrative, mospërputhje me të dhëna të vetëdeklaruar, dhe vlerësim negativ për sjelljen në komunitet, përbën një kriter ligjor objektiv, të parashikuar shprehimisht nga neni 82 i ligjit nr. 82/2024, i cili aplikohet në mënyrë të përgjithshme për çdo kandidat, pavarësisht nga çdo shkak i mbrojtur nga neni 1 i LMD-së. Ankuesi identifikon si “çdo shkak tjetër” të pretenduar faktin që ka qenë i shoqëruar tri herë në polici për sqarime konfliktesh verbale, pra, të njëjtin fakt që përbën objekt të vetë vlerësimit të besueshmërisë. Në këto kushte, fakti i pretenduar si “çdo shkak tjetër”/shoqërimet në polici, përkon me kriterin objektiv ligjor mbi të cilin bazohet vendimmarrja e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, dhe jo me një karakteristikë të mbrojtur, të papërshtatshme apo të palidhur me qëllimin legjitim të verifikimit të besueshmërisë për ushtrimin e funksioneve policore.

Në lidhje me kërkesat e tjera të ankuesit, verifikimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të vendimit të përjashtimit, si dhe kërkesën për rivlerësim të çështjes në themel, Komisioneri sqaron se, në përputhje me sa është parashtruar në pikën II të këtij vendimi, kompetenca e tij kufizohet në shqyrtimin e elementit të diskriminimit dhe nuk shtrihet në vlerësimin e ligjshmërisë apo të bazueshmërisë në themel të vendimeve administrative të subjekteve përgjegjëse, çështje këto që mbeten në kompetencë të gjykatës administrative. Në këtë kuptim, neni 7/a, i ligjit nr. 49/2012 *“Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”*, të ndryshuar, përcakton se: *“Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;...”*, që mbështet konkluzionin se çështjet e ligjshmërisë dhe të proporcionalitetit të aktit administrativ të përjashtimit mbeten në juridiksionin e gjykatës administrative dhe jo në atë të Komisionerit.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 17/2, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohej t’i refuzohet një personi ose grupi personash pranimit në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi, duke e përkufizuar diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.

Në nenin 4, Konventa e ILO-s parashikon se: *“Nuk konsiderohen diskriminim të gjitha ato masa që prekin një individ për të cilin dyshohet me të drejtë se kryen aktivitet të dëmshëm për sigurimin e Shtetit apo provohet se me të vërtetë e zhvillon këtë aktivitet, por me kusht që ky person të ketë të drejtën t’i drejtohet një instance kompetente që është krijuar sipas praktikës kombëtare”*. Kjo dispozitë e së drejtës ndërkombëtare mbështet konkluzionin se masat e verifikimit të besueshmërisë, të ndërmarra ndaj kandidatëve për në strukturat e Policisë së Shtetit, mbi bazën e

kritereve objektive dhe në zbatim të procedurave të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, nuk përbëjnë në vetvete diskriminim, për aq kohë sa i nënshtrohen mundësisë së kundërshtimit pranë një instance kompetente.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe në mungesë të një krahasuesi, që të provojë se ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se një person tjetër në një situatë të krahasueshme, në kushtet kur kriteri i zbatuar rezulton objektiv, i parashikuar me ligj dhe i zbatuar në mënyrë të njëtrajtrashme ndaj të gjithë kandidatëve, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtroar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë dhe Komisariatit të Policisë Përmet.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë dhe Komisariatit të Policisë Përmet, për shkakun “çdo shkak tjetër” të pretenduar nga ankuesi, A. P., dhe për rrjedhojë nuk provohet se subjektet e sipërcituara kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A. P., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë dhe Komisariatit të Policisë Përmet.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)